



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I
MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR KUSHTET E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË PLATFORMËS
SHUMËPALËSHE TË TREGTIMIT - MTF**

Miraturar me vendimin e Bordit nr. 160, datë 21.11.2012

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i kushteve për organizimin dhe funksionimin e Platformës Shumëpalëshe të Tregtimit, që në vijim do të quhet MTF, si dhe kushtet që duhet të plotësojnë operatorët për të vënë në funksionim këtë platformë.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në përputhje me nenin 42 pika 10 dhe nenin 78 paragrafi 3 i Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.

**Neni 3
Përkufizime**

Për qëllim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **Platforma Shumëpalëshe e Tregtimit** ose **MTF (Multilateral Trading Facility)**– nënkupton një sistem shumëpalësh, i vënë në funksionim nga Bursa e Titujve apo një Shoqëri Komisionere, i cili bashkon palët e interesuara për të shitur dhe blerë tituj dhe instrumenta financiare sipas rregullave të përcaktuara.

- b) **Operator i MTF-së** - nënkupton Bursën e Titujve apo një Shoqëri Komisionere, e cila mund të vërë në funksionim një MTF.
- c) **Përdoruesi i MTF-së** - nënkupton çdo person, i cili ka të drejtë hyrje në sistemin e MTF.
- d) **Autoritet** - nënkupton Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare
- e) **Ligji “Për titujt”** - nënkupton Ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”

Neni 4

MTF – si veprimtari e lidhur me transaksione me tituj

Autoriteti konsideron organizimin dhe funksionimin e MTF-së si veprimtari të lidhur me transaksione me tituj.

Neni 5

Operatorët

1. Bursa e Titujve e licencuar nga Autoriteti mund të vërë në funksionim një MTF, pas plotësimit të kërkesave të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëritë Komisionere, dhe bankat si shoqëri komisionere të licencuara nga Autoriteti, mund të vënë në funksionim një MTF, pas plotësimit të kërkesës së nenit 52 paragrafi 3 i Ligjit “Për titujt” në lidhje me kërkesën për kapital, si dhe kërkesave të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Kërkesat për marrjen e licencës

1. Bursa e titujve, shoqëria komisionere, dhe banka si shoqëri komisionere, e cila kërkon të vërë në funksionim një MTF duhet të depozitojë në Autoritet një kërkesë për pajisje me licencë për të vënë në funksionim një MTF, pas plotësimit të kërkesave të nenit 5 të kësaj rregulloreje dhe pas depozitimit të informacionit që lidhet me:

- a) sistemin e tregtimit;
- b) mundësinë e futjes së të dhënave në lidhje me ofertat dhe kërkesat, si dhe të dhënave të tregtimit për gjithë përdoruesit e sistemit dhe publikun;
- c) përdoruesit e mundshëm të sistemit;
- d) titujt dhe instrumentat financiare që do të tregtohen brenda sistemit;
- e) mekanizmat dhe metodat e shlyerjes së transaksioneve;

f) deklarata që sigurojnë përputhshmërinë me kërkesat e Ligjit “Për titujt” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

2. Kërkesa për pajisje me licencë shoqërohet, gjithashtu, me të gjitha rregullat e funksionimit të MTF-së të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Operatori i MTF-së duhet të njoftojë Autoritetin pa vonesë në lidhje me çdo ndryshim të të dhënave të depozituara në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 7

Rregullat e funksionimit të MTF-së

1. Operatori i MTF-së harton dhe zbaton rregulla dhe procedura transparente në lidhje me:

- a) të drejtat e hyrjes së përdoruesve për të vepruar në sistem;
- b) kriteret për përcaktimin e titujve dhe instrumentave financiare që mund të tregtohen në sistem;
- c) tregtimin;
- d) shlyerjen e transaksioneve.

2. Rregullat dhe procedurat, referuar paragrafit të parë të këtij neni, duhet t’i japin mundësinë përdoruesve të përdorin sistemin në mënyrë efektive dhe të kuptojnë risqet që lidhen me përdorimin e hapësirave që krijon MTF.

Neni 8

Rregullat mbi të drejtën e hyrjes në sistemin e MTF

1. Operatori i MTF-së gjatë hartimit dhe zbatimit të rregullave, në lidhje me të drejtën e hyrjes së përdoruesve në sistemin që ofron MTF, duhet të ketë parasysh që këto rregulla të jenë:

- a) të qarta dhe jo-diskriminuese; dhe
- b) të bazuara në kritere objektive.

2. Operatori i MTF-së lejon që marrja, transmetimi dhe ekzekutimi i urdhrave në sistemin e MTF të bëhet nëpërmjet komisionerëve të bursës (broker/dealer) të licencuar nga Autoriteti.

Neni 9

Rregullat mbi titujt dhe instrumentat financiarë të tregtueshëm në MTF

1. Operatori i MTF-së gjatë hartimit dhe zbatimit të rregullave, në lidhje me kriteret për përcaktimin e titujve dhe instrumentave financiarë të tregtueshëm në MTF duhet të ketë parasysh që:

- a) të ofrohet një informacion publik i mjaftueshëm dhe i përdorshëm në lidhje me titujt dhe instrumentat financiarë që tregtohen në sistemin e MTF, në mënyrë që përdoruesit të jenë në gjendje të krijojnë një gjykim të qartë mbi investimin;
- b) informacioni të ofrohet në momentin kur titulli apo instrumenti financiar pranohet për tregtim, si dhe gjatë procesit të tregtimit;
- c) informacioni të ofrohet edhe në lidhje me natyrën e llojeve të titujve dhe instrumentave financiarë që tregtohen në sistemin e MTF.

2. Operatori i MTF-së duhet të zbatojë menjëherë çdo vendim të Autoritetit në lidhje me pezullimin apo tërheqjen e një titulli apo instrumenti financiar nga tregtimi.

Neni 10

Përfshirja e emetuesit nga dhënia e informacionit

Nëse një titull i tregtueshëm, i cili është pranuar për t'u tregtuar në Bursën e titujve, tregtohet dhe në MTF pa pëlqimin e emetuesit, emetuesi nuk do të jetë subjekt i ndonjë detyrimi në lidhje me dhënien e informacionit të vazhdueshëm për këtë MTF.

Neni 11

Rregullat mbi tregtimin në MTF

1. Operatori i MTF-së gjatë hartimit dhe zbatimit të rregullave në lidhje me tregtimin në sistemin e MTF, duhet të ketë parasysh që këto rregulla:

- a) të sigurojë tregtim dhe caktim të drejtë dhe të rregullt të çmimeve, përfshirë këtu edhe çmimet referencë;
- b) të sigurojë ekzekutim eficient të urdhrave;
- c) të mos i lejojë operatorit të MTF-së të bëjë vlerësime sipas dëshirës;

2. Përdoruesit e sistemit (broker/dealer), të cilët veprojnë në emër të klientëve të tyre për ekzekutimin e urdhrave në sistemin e MTF-së, duhet të plotësojnë të njëjtat kërkesa si në rastin e ekzekutimit të urdhrave në Bursën e titujve të përcaktuara në Ligjin "Për titujt" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji.

Neni 12

Rregulla mbi shlyerjen e transaksioneve

1. Operatori i MTF-së gjatë hartimit dhe zbatimit të rregullave ne lidhje me shlyerjen e transaksioneve duhet të ketë parasysh që këto rregulla:

a) të sigurojnë kushtet e nevojshme për të mundësuar shlyerjen efiçente të transaksioneve që kryhen në sistemin e MTF-së;

b) të përcaktojnë qartë përgjegjësitë e përdoruesve të sistemit për shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në këtë sistem.

2. Përgjegjësitë e përdoruesve të sistemit për shlyerjen efiçente të transaksioneve paraqiten në marrëveshjen e nënshkruar mes operatorit të MTF-së dhe përdoruesit.

Neni 13

Monitorimi për zbatimin e rregullave të funksionimit të MTF-së

1. Përdoruesit e MTF-së duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e funksionimit të MTF-së.

2. Operatori i MTF-së duhet të hartojë rregulla dhe procedura për monitorim të rregullt të transaksioneve të ndërmarra nga përdoruesit e sistemit, me qëllim që të identifikojnë mangësitë e mundshme të rregullave, kushtet jo të rregullta të tregtimit, ose veprimet që mund të çojnë në praktika të paligjshme të tregtimit.

3. Operatori i MTF-së duhet të ketë marrë masat e nevojshme dhe të ketë hartuar rregulla dhe procedura për monitorim të rregullt të veprimeve të përdoruesve me rregullat e MTF.

4. Kur operatori i MTF-së evidenton një nga situatat e paragrafit të dytë të këtij neni, njofton pa vonesë Autoritetin.

5. Kur operatori i MTF-së evidenton një nga situatat e paragrafit të dytë të këtij neni, ai mund të përjashtojë përkohësisht apo përgjithmonë përdoruesin nga sistemi.

6. Operatori i MTF-së duhet, me kërkesë të Autoritetit dhe pa vonesë, të kërkojë çdo informacionin i cili është i nevojshëm për mbikëqyrjen e rasteve të përmendura në paragrafin e dytë të këtij neni.

7. Operatori i MTF-së duhet të ofrojë mbështetje për Autoritetin në mbikëqyrjen e rasteve të praktikave të paligjshme të ndodhura brenda sistemit.

Neni 14

Kërkesat për publikimin e transaksioneve para tregtimit

1. Para fillimit të tregtimit, operatori i MTF-së duhet të publikojë në faqen zyrtare të tij, çmimet e ofruara për shitjen dhe blerjen (bid and offer), si dhe intensitetin e interesave të paraqitura për këto çmime për aksionet e pranuar për t'u tregtuar në Bursën e titujve dhe që janë njoftuar të tregtohen brenda sistemit të MTF-së.

2. Informacioni që i referohet paragrafit të parë të këtij neni, duhet të jetë në dispozicion të publikut me kushte tregtare të arsyeshme dhe i vazhdueshëm gjatë orëve të tregtimit.

3. Autoriteti mund të mos kërkojë respektimin e detyrimit nga operatori i MTF-së të lindur nga paragrafi i parë dhe dytë i këtij neni, në rastet kur gjykon se modeli i tregut ose lloji dhe madhësia e urdhrave krijon mundësinë për mosrespektimin e detyrimit. Ky parashikim mund të ndodhë në rastin e transaksioneve që janë në një volum më të lartë në krahasim me madhësinë normale të tregut për klasa të caktuara aksionesh.

Neni 15

Kërkesat për publikimin e transaksioneve pas tregtimit

1. Operatori i MTF-së duhet të publikojë në faqen zyrtare të tij çmimet, volumin dhe kohën e transaksionit të ekzekutuar në sistemin e MTF në lidhje me aksionet e pranuar për tregtim në Bursën e titujve.

2. Informacioni që i referohet paragrafit të parë të këtij neni, duhet të jetë në dispozicion të publikut me kushte tregtare të arsyeshme dhe në kohë reale.

3. Autoriteti, sipas kërkesës së operatorit të MTF-së, mund të autorizojë këtë të fundit të shtyjë publikimin e detajeve të kërkuara në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, bazuar në llojin dhe madhësinë e transaksionit.

4. Shtyrja e publikimit mund të autorizohet për transaksione që janë në një volum të lartë në krahasim me madhësinë normale të tregut për klasa të caktuara aksionesh. Operatori i tregut duhet të bëjë publike masat e marra për shtyrjen e publikimit të tregtimit.

Neni 16

Mbikëqyrja e MTF-së nga Autoriteti

Të gjitha dispozitat e Ligjit "Për Titujt" për mbikëqyrjen dhe raportimin e Bursës së titujve janë të zbatueshme edhe për operatorin e MTF-së.

Neni 17

Miratimi ose refuzimi i licencës

1. Autoriteti, brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të dokumentacionit të plotë të kërkuar në nenin 6 të kësaj rregullore, merr vendim për miratimin apo refuzimin e licencës për vënien në funksionim të MTF-së nga operatori kërkuar.

2. Autoriteti miraton dhënien e licencës nëse gjykon se:

- a) operatori plotëson të gjitha kushtet e nenit 6 të kësaj rregullore;
- b) operatori ka sistemin e përshtatshëm të tregtimit që siguron të drejta hyrje të njëjta për të gjithë përdoruesit, si dhe ofron një informacion publik të mjaftueshëm dhe të përdorshëm në lidhje me titujt dhe instrumentat financiare që tregtohen në sistemin e MTF-së;
- c) rregullat e MTF-së janë të qarta dhe transparente dhe u japin mundësi përdoruesve të përdorin një sistem eficient dhe të kuptojnë risqet që lidhen me përdorimin e hapësirave që krijon MTF;
- d) operatori i MTF-së ka marrë të gjithë masat për monitorim të rregullt të procesit të tregtimit dhe shlyerjes së transaksioneve.

3. Autoriteti refuzon licencën për vënien në funksionim të MTF-së nëse:

- a) Vëren që kushtet sipas paragrafit 2 të këtij neni nuk përmbushen,
- b) Arrin në përfundimin që dhënia e licencës do të jetë në dëm të interesit publik.

4. Operatori që kërkon të pajiset me licencë për vënien në funksionim të MTF-së detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit: **(shfuqizuar)**

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Enkeleda SHEHI